

STATUT I SHOQËRISË

"Tirana Training Center" sh.p.k

Sot më datë, 04.10.2017 ortakut i Shoqërisë "Tirana Training Center" sh.p.k vendosi që në bazë të ligjit të hartojë dhe miratojë statutin e Shoqërisë "Tirana Training Center" sh.p.k, i cili do të shërbëjë njëkohësisht edhe si akt themelimi, duke u integruar në një akt të vetëm, me përmbajtje si më poshtë vijon:

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SË INTERNETIT

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. **"Tirana Training Center" sh.p.k** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me datë themelimi 04.10.2017 në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar dhe që funksionon në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
2. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"Tirana Training Center" sh.p.k**.
3. Në çdo dokument apo akte të tjera shkresore, fatura, njoftime dhe komunikime të tjera, por pa u kufizuar në këto të fundit, të nxjerra ose të pranuara prej shoqërisë, emri i saj do të paraprihet ose do të pasohet nga:
 - a. Fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "sh.p.k";
 - b. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS);
 - c. Vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj, si dhe
 - d. Shënimin përkatës nëse kjo shoqëri është në likuidim.
4. Ortaku themelues i Shoqërisë **"Tirana Training Center" sh.p.k** është:
 - **Andi Gumaj**, atësia Spartak dhe amësia Fatbardha, me datëlindje 12.08.1986, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. "Sytki Çiço", Pallati 1, Ap. 17, Zip 1001, Cel: 069 20 36 360, posedues i letërnjoftimit shqiptar me nr. 024741397 dhe nr. personal I60812067M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Neni 2
Objekti

1. Shoqëria do të ushtrojë kryesisht aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Ofrim shërbimesh në fushën e arsimit, edukimit, trajnimeve, formimit profesional dhe/ose akademik, por pa u kufizuar në to, përsa i përket ofrimit të shërbimeve që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me edukimin në përgjithësi;
 - b) Krijim, organizim, financim dhe menaxhim i qendrave, terreneve dhe aktiviteteve sportive, të hapura ose të mbyllura, por pa u kufizuar në to, për sa lidhet me kryerjen e çdo veprimtarie dhe ofrimit të çdo shërbimi që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me sportet;
 - c) Pjesëmarrje, financim dhe/ose realizim i projekteve që lidhen me ofrimin e shërbimeve në fushën e edukimit dhe sportit, por pa kufizuar mundësinë e shoqërisë që të kryejë të njëjtat veprimtari edhe në rastet kur nuk lidhen me edukimin dhe/ose sportin;
 - d) Import-eksport i veshjeve dhe/ose pajisjeve sportive dhe i mallrave të tjerë që vlerësohen të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve sportive, por pa kufizuar mundësinë e shoqërisë që të kryejë import-eksport edhe të mallrave të tjerë që nuk lidhen me këto lloj aktiviteteve;
2. Gjithashtu shoqëria mund të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera, të papërmendura si më lart, si zotëruese kapitali, nëpërmjet blerjes së kuotave, aksioneve apo të aktivitetit tregtar, të krijojë shoqëri të reja, degë dhe/ose zyra përfaqësimi, etj., brenda dhe jashtë vendit, si dhe të ushtrojë çdo aktivitet tjetër tregtar për sa kohë që nuk bie në kundërshtim me ligjin shqiptar.

Neni 3
Kohëzgjatja

1. Shoqëria do të kryejë aktivitet tregtar për një afat të pacaktuar.

Neni 4
Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike

1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. "Perlat Rexhepi", Pallati "Unicon", Shkalla 1, Kati 1, Ap. 3, Tiranë.
2. Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvendosë zyrën e saj qendrore ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë.
3. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me miratim paraprak me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

**KREU II
KAPITALI**

Neni 5
Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në para në vlerën 100 Lekë (njëqind), i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100 Lekë (njëqind), kuotë e cila zotërohet në masën 100% (njëqind përqind) nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.
2. Në rast se në vijim të veprimtarisë së shoqërisë, Asambleja e Pergjithshme do të vendosë të zmadhojë kapitalin e shoqërisë edhe përmes kontributeve në natyrë, ortakët *(këtu e në vijim të gjitha referencat në këtë statut për sa i përket 'ortakëve' lidhen me parashikime për situatat kur mund të rezultojë në vijim që Shoqëria të ketë më shumë se një ortak)*, do i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjellë me njëri-tjetrin dhe do i shprehin vlerat e tyre në para.
3. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje për sa më lart, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës kompetente, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, për të patur një vendimarrje përfundimtare gjyqësore lidhur me përcaktimin e vlerës në para të kontributit në natyrë të ortakëve.
4. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve do të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Neni 6
Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës/kuotave hartohet në formë shkresore, pa qënë e nevojshme shprehja e vullnetit përpara noterit si kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Me përjashtim të rastit nëse palët bien dakord ndryshe në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve me efekt deklarativ, duke përfshirë këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.
3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tyre në favor të përfituesit të kuotës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

4. Nëse njëri nga Ortakët do të transferojë nëpërmjet shitjes të gjithë apo një pjesë të kuotës që ka në zotërim në favor të një personi të tretë që nuk është ortak i shoqërisë, ofertën e të cilit ai e ka përzgjedhur si më të përshtatshmen, atëherë ky ortak do të njoftojë menjëherë ortakët e tjerë dhe Administratorin/ët e shoqërisë me postë rekomande, shoqëruar dhe me një njoftim në adresën e postës elektronike të secilit ortak dhe të administratorit/ëve (nëse kanë), në të cilin duhet të përcaktohen kushtet e transferimit të ardhshëm të kuotës së tij. Njoftimi për Shitje duhet të përfshijë ndër të tjera (i) emrin e përfituesit të kuotës; (ii) çmimin që do të paguhet për kuotën.
5. Ortakët e tjerë brenda (30) tridhjetë ditëve nga dita që kanë marrë njoftimin për shitjen e kuotës ose një pjese të saj mund:
- a) Të refuzojnë transferimin e kuotës te Blerësi i Ofruar me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar, me postë rekomande Ortakut Shitës dhe Administratorit/ëve të Shoqërisë brenda 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e marrjes të Njoftimit të Shitjes dhe në këtë njoftim t'i bëjnë Ortakut Shitës një ofertë për blerjen e kuotës ose pjesës së kuotës që është në shitje, në rast se në shitje është vetëm një pjesë e saj. Ortaku Refuzues nuk mund të bëjë një ofertë të pjesshme, apo të ofrojë që të blejë kuotën për një çmim blerje më të ulët sesa ai i ofruar nga Blerësi i Ofruar apo me kushte më të disfavorshme sesa kushtet e ofertës së Blerësit të Ofruar.
 - b) Nëse Ortaku Refuzues nuk bën ofertë për blerjen e Kuotës në Shitje në kushtet e parashikuara në këtë seksion dhe brenda afatit (45) ditor që nga dita që i është bërë njoftimi për shitje, atëherë Ortaku Shitës ka të drejtë që të shesë Kuotën në Shitje çdo personi tjetër me kusht që kjo shitje të mos bëhet me çmim më të ulët dhe kushte më të favorshme sesa ato të ofruara nga Blerësi i Ofruar, përndryshe kjo shitje do të konsiderohet e pavlefshme. Kështu, për evitim të çdo dyshimi, Ortaku Shitës sa herë që do të ofrojë për shitje kuotën e tij me çmim apo me kushte më të favorshme sesa ato të njoftuara Ortakut tjetër, këtë ofertë për shitje duhet që t'ia drejtojë më përpara këtij Ortaku për t'i dhënë mundësinë këtij të fundit që të ushtrojë të drejtën e tij të refuzimit fillestar.
 - c) Në rast se më shumë se një Ortak ushtron të drejtën e parablerjes, secili prej tyre ka të drejtë të blejë një përqindje të kuotës proporcionalisht me vlerën e kapitalit të zotëruar nga Ortakët të cilët kanë ushtruar të drejtën e parablerjes në mënyrën e duhur sipas parashikimeve të mësipërme.
 - d) Ortakët dhe të drejtat e fituara si rezultat i transferimit nuk mund të ushtrohen ndaj personave të tretë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve.
6. Ortakët nuk kanë të drejtë që të krijojnë barrë, peng, apo kufizime të tjera mbi kuotën e tyre pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme. Miratimi i Asamblesë do të jetë i vlefshëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë 1/2 e kapitalit të shoqërisë dhe me vendimmarrje të cilësuar prej 3/4.

KREU III ORGANET E SHOQËRISË

Neni 7

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme ;
2. Administratori/Administratorët.

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - m) shitja, barrësimi, vendosja peng apo hipotekimi i çdo titulli, të drejte ose interesi mbi aktivet ose pronat e shoqërisë;
 - n) miratimin e huave ose garancive nga shoqëria për detyrimet e palëve të treta;
 - o) marrja e kredive dhe/ose overdraft-ve nga bankat ose nga institucione të tjera financiare;
 - p) transferimi i markave dhe çdo pronësie intelektuale të shoqërisë ose të zotëruara nga shoqëria në bazë të licencave përkatëse;
 - q) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e administratorëve dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 9

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët/i dhe/ose nga Ortakët/u, të cilët zotërojnë kuota, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të cilët mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk

thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e kuotave të zotëruara prej tyre.
2. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
3. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e mëposhtme:
- I. Në rastet e përcaktuara nga Ligji *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e këtij statuti si dhe sa herë që mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë;
 - II. Kur, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim;
 - III. Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktivë, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
 - IV. Kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
4. Në rastet e parashikuara në pikat II), III) dhe IV) të paragrafit 3 të këtij neni, Asamblesë së Përgjithshme duhet t'i paraqitet një raport nga një ekspert i autorizuar i pavarur, me përjashtim të rasteve kur blerjet kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe kryhen në kushte normale tregu.
5. Në rastet e parashikuara në pikat II), III) dhe IV) të paragrafit 3 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e administratorëve.
6. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë ortakëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;

- b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga ortakët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:
 - i. të drejtat e ortakëve të pakicës për të kërkuar mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose për të kërkuar përfshirjen e çështjeve të caktuara në rendin e ditës;
 - ii. procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;
 - iii. procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
 - c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë rendin e ditës bashkë me vendimet e propozuara për çdo çështje si dhe tekstin e ndryshimeve të statutit nëse Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim në lidhje me të;
 - d) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen.
8. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
9. Të paktën 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion ortakëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:
- a) informacionin sipas pikave 6 e 7 të këtij neni;
 - b) numrin total të kuotave dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre kuotave në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes;
 - c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme.
10. Administratori/administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë për sqarim për rendin e ditës dërguar nga ortakët, jo më vonë se (8) tetë ditë përpara datës së vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
11. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
12. Mbledhjet e Asamblesë duhet të mbahen në selinë e regjistruar të shoqërisë ose në çdo vend tjetër në Shqipëri. Gjatë Mbledhjes së Asamblesë përgatitet lista e Ortakëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e kuotave, numrin e votave që këto kuota japin dhe vlerën e kuotës në kapitalin e shoqërisë. Kjo listë u vihet në dispozicion ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre. Ortaku mund të

përfaqësohet në Mbledhjet e Asamblesë përmes një përfaqësuesi të autorizuar, që mund të jetë ortak ose një i tretë. Administratorët nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme

13. Asambleja e Përgjithshme duhet të mbajë të paktën një mbledhje vjetore.

14. Asambleja e Përgjithshme merr vendime nëpërmjet:

- a) pjesëmarrjes fizike të ortakëve apo të përfaqësuesit të autorizuar të tyre në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme; apo
- b) mjeteve elektronike, pa qënë nevoja e pjesëmarrjes fizike të ortakëve (Vendimarrja Elektronike).

15. Pjesëmarrja dhe vendimarrja e ortakëve në mbledhje mund të realizohet me mjete të ndryshme komunikimi elektronik, me kusht që të garantohet identifikimi i tyre. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson ortakëve të shprehen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qënë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

16. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve marrjen pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

17. Administratori/administratorët e shoqërisë duhet t'u dërgojnë ortakëve përmes faksit apo postës elektronike, përveç dokumentave të tjerë mbi bazën e të cilëve do të merret vendimi, kopje të njëjta të draftit të vendimeve me hapësirën përkatëse për pranimin apo refuzimin e vendimeve dhe instruksionet e votimit. Ortaku në varësi të votimit të tij do të vendosë shënimin në hapësirën përkatëse, do t'a nënshkruajë draft-vendimin dhe do t'ia kthejë administratorit/administratorëve me postë brenda afatit të caktuar në njoftim.

Neni 10

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe Kuorumi

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit të shoqërisë. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të

cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, apo përfaqësuesit e tyre, janë të pranishëm në mbledhje personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike në përputhje me parashikimet e statutit dhe në këtë rast vendimet merren me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ e ortakëve pjesëmarrës që janë të nevojshëm për formimin e kuorumit për marrjen e vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur si më lart, ajo mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
3. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me financat e shoqërisë, veçanërisht me mbulimin e humbjeve, miratimin e buxhetit vjetor, zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, do të merren me unanimitet nga ana e ortakëve.
4. Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e ortakëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me përqindjen e zotëruar në kapital nga secili prej tyre. Kjo listë u vihet në dispozicion ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.
5. Asambleja e Përgjithshme cakton një kryetar.
6. Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për 15 (pesëmbëdhjetë) minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
7. Administratori pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të ortakëve.

Neni 11

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të thjeshtë, për ato çështje të parashikuara në nenin 8 të statutit, për të cilat ligji nuk kërkon shumicë të cilësuar, me përjashtim të çështjeve të tjera që rast pas rasti ky statut, pavarësisht nga parashikimet e ligjit, vendos se gjithashtu do të miratohen me shumicë të cilësuar.
2. Asambleja e Përgjithshme do të votojë duke respektuar parashikimet, kufizimet dhe përjashtimet si më poshtë:
 - I. asambleja e përgjithshme i merr vendimet, nëpërmjet votimit të hapur;
 - II. për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga ortakët, të cilët zotërojnë një numër kuotash, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;

- III. çdo ortak mban të drejtën e një vote;
- IV. ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse asambleja e përgjithshme duhet të marrë vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
- V. Ndalimi i parashikuar në rastet e pikës IV) vlen edhe për personin e autorizuar për të përfaqësuar ortakun.
3. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet që të regjistrohen në përputhje me parashikimet e mëposhtme:
- i. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
 - ii. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimarrjen, si dhe të ortakëve, që janë shprehur kundër;
 - iii. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
 - iv. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
 - v. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.
5. Vendimet e marra në Asamblenë e Përgjithshme mund të nënshkruhen në një regjistrin e vendimeve, që përbën një dokument të ndryshëm nga procesverbali, në kopje të mjaftueshme për ortakët e shoqërisë dhe për depozitimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
6. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë e vendimeve të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 12

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët e shoqërisë brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Neni 13

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.
2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të kapitalit në asamblenë e shoqërisë brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Ortakët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.
5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi.
6. Ortakët në pakicë të përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky statut apo ligji ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 14


Të drejtat që lidhen me zotërimin e kuotës

1. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.
2. Janë të pavlefshme marrëveshjet, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e Ortakëve që rrjedhin nga nenet 12, 13 dhe paragrafi i parë i nenit 14 të këtij statuti si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.

Neni 15

Largimi i ortakut

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse:
 - a) ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij;
 - b) nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij;
 - c) nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme; apo
 - d) për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.



3. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njej si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
4. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Neni 16 **Përfshirja e ortakut**

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përfshirjen e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfshirje.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përfshirjen e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
 - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
 - d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
3. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përfshiruar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përfshirjen.
4. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përfshirjen.

Neni 17 **Administratori/ët**

1. Administrator i Shoqërisë, duke u emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare do të jetë:
 - **Andi Gumaj**, atësia Spartak dhe amësia Fatbardha, me datëlindje 12.08.1986, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. "Sytki Çiço", Pallati 1, Ap. 17, Zip 1001, Cel: 069 20 36 360, posedues i letërnjoftimit shqiptar me nr. 024741397 dhe nr. personal I60812067M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë (*Referencat në këtë statut në lidhje me 'administratorin'*

do të mbahen në konsideratë për aq sa janë të mundshme për t'u zbatuar edhe në rast se në vijim do të rezultojë që Shoqëria të ketë më shumë se një administrator).

3. Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen dhe shoqëria do të përfaqësohet nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e tyre si më poshtë:
 - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - f) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - g) të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - h) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorit/ëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 18

Detyrimi i Besnikërisë, Informimit dhe Përgjegjësia e Administratorit/ve

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, Administratori/ët e shoqërisë veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë në radhë të parë dhe të gjithë ortakëve të saj në mënyrë të barabartë. I njëjti detyrim vlen dhe për ortakët e Shoqërisë.
2. Administratori/ët e shoqërisë kanë detyrim të informojnë rregullisht çdo 3 (tre) muaj të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë sipas mënyrës së kërkuar nga secili ortak dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në shpenzimet e shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, deklarata për të ardhurat, deklarata tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të shoqërisë etj.

3. Informacioni i kërkuar sipas pikës 2 të këtij neni duhet të vihen në dispozicion për shqyrtim nga ortaku i interesuar pranë selisë së Shoqërisë. Nëse administratori/ët nuk japin informacionin e kërkuar sipas këtij paragrafi brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, ortaku i interesuar brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojë përmbaruesit gjyqësorë të ekzekutojnë kërkesën e ortakut duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që Administratori/ët nuk kanë dhënë.

Neni 19

Shkarkimi i administratorit/ëve

1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
 - a) personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
 - b) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
 - c) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
 - d) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 20

Këshilli i Punëmarrësve

1. Në momentin që numri i punëmarrësve në shoqëri do të kalojë shifrën (20) njëzet punëmarrës, atëherë shoqëria do të krijojë Këshillin e Punëmarrësve dhe ushtrimin e funksioneve të tij në përputhje me parashikimet e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
2. Pa paragjykuar të drejtat e Këshillit të Punëmarrësve të njohura me ligj, Këshilli i Punëmarrësve nuk do të ketë përfaqësuesitë tij në administrimin e shoqërisë, me përjashtim të rastit kur vendoset ndryshe në marrëveshje të përfaqësuesitë të shoqërisë me Këshillin e Punëmarrësve.

Neni 21

Eksperti Kontabel i Autorizuar

1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme cakton ekspertin kontabël të shoqërisë.
2. Eksperti kontabël është në këtë detyrë për një mandat 1 (një) vjeçar, në përputhje me vitin financiar të shoqërisë.



3. Eksperti kontabël, ose përfaqësuesi i personit juridik, kur ekspert është zgjedhur një person juridik, me kërkesën e secilit prej ortakëve u vë në dispozicion atyre kopje të njesuara me origjinalin, të vulosura me vulën e tij, të akteve ose dokumentacionit që ndodhet pranë tij ose është përpiluar prej tij në kuadër të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

Neni 22
Viti Fiskal

1. Viti fiskal i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

KREU IV
DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 23
Dividendët

1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të shpërndajë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhën në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat për periudhën për të cilën paguhet dividendi.
3. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda 12 (dymbëdhjetë) vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.
4. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim;
5. Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshoj këtë certifikatë.
6. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.



7. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese në kundërshtim me sa më lart, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
8. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë ose kur në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

Neni 24

Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar

1. Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

KREU V

PRISHJA E SHOQËRISË DHE NJOFTIMET

Neni 25

Prishja dhe likuidimi


1. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
2. Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve.
3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
4. Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit në përputhje me pikën 3 të këtij neni, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
5. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

6. Administratori i shoqërisë i njofton për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim".
7. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emërimit të tij.
8. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
9. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga asambleja e përgjithshme.
10. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve.
11. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit i paraqesin asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij.
12. Nëse asambleja e përgjithshme miraton raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.
13. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve.
14. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

Neni 26

Dispozita të ndryshme

1. Ky akt që përbën statut dhe akt themelimi të shoqërisë mund të shtohet, ndryshohet ose të zëvendësohet me një Statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të cilësuar.



2. Riorganizimi apo prishja e Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
3. Ortakët dhe administratorët do të ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me parimet e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe në veçanti duke respektuar detyrimin për besnikëri të parashikuar në këtë ligj.
4. Në emërimin apo caktimin e administratorëve, përfaqësuesve të ortakëve, apo përfaqësuesve të tjerë ligjorë të shoqërisë, duhet të mbahet parasysh që këto persona të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në Kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 (pesë) vjet nga data e këtij dënimi.
5. Shoqëria në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijjë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e mirëadministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikat që ndiqen prej saj, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Deklarata e mirëadministrimit të shoqërisë duhet të përmbajë një profil të administratorëve si dhe të shpjegojë elementët e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria. Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
6. Të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë Statut, i nënshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në versionin e tij në fuqi, dispozitat e Kodit Civil dhe çdo lloj ligji të aplikueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Neni 27

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje e mundshme ndërmjet palëve do të zgjidhet me mirëkuptim.
2. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut hartohet në 2 (dy) kopje origjinale dhe u miratua nga Asambleja e Përgjithshme më datë 04.10.2017

Asambleja e Përgjithshme

ORTAKU I VETËM:

Z. Andi GUMAJ

